

**KONTRATE**  
**PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“DM.ORGANIK” SHPK**

Sot me date 05 Dhjetor 2020, ne ortaket themelues:

**1.Daklea Allko**, atesia Shaban, lindur ne Çorovode, Skrapar, me 20.02.1987, me numer personal I752200780 dhe banuese ne Tirane, L.21 Dhjetori, Rr.Ylbere Bylykbashi, Pallati nr.26/1, me shtetesi shqiptare, mbajtese e Pasaportes nr.BG9619749;

**2.Edmond Zeqaj**, atesia Muim, lindur ne Tirane, me 18.07.1989, me numer personal I90718063K dhe banues ne Tirane, L.5, Rr.Sami Frasheri, Pallati nr.11, Shk.3, me shtetesi shqiptare, mbajtes i Pasaportes nr.BJ9073654;

me vullnetin tone te lire e te plote, kemi vendosur si me poshte vijon:

Neni 1

Emri, forma, selia e shoqerise

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, me emrin:

“DM.ORGANIK” Shpk, (qe ketu e me poshte do te quhet shoqeria), me seli ne Kavaje, fshati Synej, pasuria nr.92/17 (Ish stallat e tufezimit te Koperatives Synej), zona kadastrale nr.3554.

Neni 2

Shoqeria “DM.ORGANIK” Shpk eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar, prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te kesaj kontrate, statutit bashkangjitur, Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar,

Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” i ndryshuar, si dhe legjislacionit tjeter shqiptar.



Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise

Kjo shoqeri do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Shoqeria ka si objekt veprimtarite e meposhtme:

- Therje, perpunim dhe shitje shpendesh, me shumice dhe pakice, si dhe import-eksportin e tyre.
- Shoqeria mundet gjithashtu te kryeje edhe çdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem, per arritjen e aktiviteteve te mesiperme.

Neni 5

Kapitali i regjistruar dhe struktura e tij

Kapitali i regjistruar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte ne shumen 100 000 leke te rinj (njqindmije), ***i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar.***

Ky kapital eshte i ndare ne 2 kuota. Pjesmarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

***1.Ortakje themeluese Daklea Allko, zoteron nje kuote te vetme:***

Iloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 50 000 leke te rinj (pesedhjetemije), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i saj ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 50 %;

***2.Ortaku themelues Edmond Zeqaj, zoteron nje kuote te vetme:***

Iloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 50 000 leke te rinj (pesedhjetemije), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i tij ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 50 %;

Neni 6

Administratore e shoqerise per nje periudhe kohe 5(pese) vjeçare, me te drejte ripertesitjeje, do te jete ortakja themeluese:



**Daklea Allko**, atesia Shaban, lindur ne Çorovode, Skrapar, me 20.02.1987, me numer personal 1752200780 dhe banuese ne Tirane, L.21 Dhjetori, Rr.Ylbere Bylykbashi, Pallati nr.26/1, me shtetesi shqiptare, mbajtese e Pasaportes nr.BG9619749;

Neni 7

Shoqeria ka te drejte te kete llogari ne leke dhe valute, ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka te drejte te disponoje lirshem mjetet monetare te mbledhura.

Neni 8

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe/ose zyra te perfaqesimit, te jete meme apo shoqeri e kontrolluar ne perputhje me legjislacionin tregtar dhe ate shqiptar ne pergjithesi.

Neni 9

Ortaket jane te detyruar te ruajne sekretin tregtar.

Neni 10

Çeshtjet e kapitalit dhe te kuotave te tij, kalimi i kuotave, menyra e administrimit te shoqerise dhe çeshtje te tjera, do te percaktohen me hollesi ne Statutin e shoqerise.

Neni 11

Kjo Kontrate Themelimi eshte hartuar ne 4(kater) origjinale, ne gjuhen shqipe, nga te cilat njera depozitohet prane QKB.

**ORTAKET THEMELUES TE "DM.ORGANIK" SHPK**

**1.Daklea Allko**

Daklea Allko 

**2.Edmond Zeqaj**

Edmond Zeqaj 

**S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“DM.ORGANIK” SHPK**

Ne ortaket themelues:

**1.Daklea Allko**, atesia Shaban, lindur ne Çorovode, Skrapar, me 20.02.1987, me numer personal I752200780 dhe banuese ne Tirane, L.21 Dhjetori, Rr.Ylbere Bylykbashi, Pallati nr.26/1, me shtetesi shqiptare, mbajtese e Pasaportes nr.BG9619749;

**2.Edmond Zeqaj**, atesia Muim, lindur ne Tirane, me 18.07.1989, me numer personal I90718063K dhe banues ne Tirane, L.5, Rr.Sami Frasheri, Pallati nr.11, Shk.3, me shtetesi shqiptare, mbajtes i Pasaportes nr.BJ9073654;

deklarojme se kemi themeluar me date 05 Dhjetor 2020, shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, me emrin “DM.ORGANIK” Shpk, (qe ketu e me poshte do te quhet shoqeria).

Neni 1

Shoqeria “DM.ORGANIK” Shpk, eshte person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik qe nga dita e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti, Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar,

Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” i ndryshuar, si dhe legjislacionit tjeter shqiptar.

Neni 2

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Kavaje, fshati Synej, pasuria nr.92/17 (Ish stallat e tufezimit te Koperatives Synej), zona kadastrale nr.3554

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe/ose zyra te perfaqesimit, te jete meme apo shoqeri e kontrolluar, ne perputhje me legjislacionin tregtar dhe ate shqiptar ne pergjithesi.



1

### Neni 3

#### Kohezgjatja e shoqerise

Kjo shoqeri do ta ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarise se Shoqerise

Shoqeria ka si objekt veprimtarite e meposhtme:

-Therje, perpunim dhe shitje shpendesh, me shumice dhe pakice, si dhe import-eksportin e tyre.

-Shoqeria mundet gjithashtu te kryeje edhe çdo aktivitet tjetër te nevojshem apo te dobishem per arrijten e aktiviteteve te mesiperme.

### Neni 5

#### Kapitali i regjistruar dhe struktura e tij

Kapitali i regjistruar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte ne shumen 100 000 leke te rinj (njqindmije), ***i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar.***

Ky kapital eshte i ndare ne 2 kuota. Pjesmarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

***1.Ortakje themeluese Daklea Allko, zoteron nje kuote te vetme:***

Iloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 50 000 leke te rinj (pesedhjetemije), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i saj ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 50 %;

***2.Ortaku themelues Edmond Zeqaj, zoteron nje kuote te vetme:***

Iloji i kontributit: ne para; vlere e kontributit 50 000 leke te rinj (pesedhjetemije), i cili eshte nenshkruar plotesisht, por nuk eshte paguar;

zoterimi i tij ne kapitalin e shoqerise eshte ne masen 50 %;

### Neni 6

#### Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave

1.Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre, fitohen apo kalohen nepermjet:

a)kontributit ne kapitalin e shoqerise;



- b)shitblerjes;
- c)trashegimise
- ç)dhurimit

d)çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

2. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.

3. Vetem ne rastet e kalimit te kuotave me shitblerje, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes, e cila duhet te ushtrohet brenda nje muaji. Ortaku, para se t'ia shesë kuoten e tij një personi te trete, detyrohet të njoftojë me shkrim, nepermjet letres rekomande me lajmerim marrje, ortaket e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë kuoten e tij, me të njëjtat kushte që do t'ia shesë personit të tretë. Brenda nje muaji nga data e marrjes se njoftimit, ortaket qe çmojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, duhet t'i komunikojne pergjigjen me shkrim, nepermjet letres rekomande me lajmerim marrje, ortakut qe do te shese kuoten. Në rast se këta nuk përgjigjen brenda nje muaji se dëshirojnë të blejnë kuoten, pra, nese nuk e ushtrojne te drejten e parablerjes brenda nje muaji, ortaku është i lirë të shesë kuoten e tij, tek personat e tretë.

## Neni 7

### Administrimi i Shoqerise


Administratore e shoqerise per nje periudhe kohe 5(pese) vjeçare, me te drejte ripërteritjeje, do te jete ortakja themeluese:

**Daklea Allko**, atesia Shaban, lindur ne Çorovode, Skrapar, me 20.02.1987, me numer personal I752200780 dhe banuese ne Tirane, L.21 Dhjetori, Rr.Ylbere Bylykbashi, Pallati nr.26/1, me shtetesi shqiptare, mbajtese e Pasaportes nr.BG9619749;

Specimenti i nenshkrimit te Administratores Daklea Allko:

Daklea Allko 



 3

## Neni 8

### Te drejtat e detyrimit e administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- ë) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne kete statut;

## Neni 9

### Përfaqësimi

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12, të Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar;
2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
3. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



## Neni 10

### Shpërblimi

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.
2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## Neni 11

### Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar, administratorët detyrohen:
  - a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3, të nenit 13 të Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar;
  - dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë





tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
- d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92, të Ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## Neni 12

### Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;

- ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji;

### Neni 13


#### Menyra e thirrjes

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 14

#### Përfaqësimi në asamble

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e pergjithshme.



3. Autorizimi jepet ne forme shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 15

#### Kuorumi

1. Meqenese te dy ortakët e shoqerise, zoterojne secili 50 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse te dy ortakët e shoqerise, te cilet se bashku zoterojne 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 17 të këtij Statuti.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 16

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme duhet te vendose vetem me unanimitetin e ortakeve, për te gjitha çështjet e renditura në nenin 12 të këtij Statuti apo dhe per çdo çështje tjetër.

#### Neni 17

#### E drejta e votes

1. Çdo ortak ka te drejta vote ne perpjestim me vleren nominale te kuotes se tij.

2. Ortakët qe nuk jane te pranishem, kane mundesine e pjesmarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

3. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

a) transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale;

b) komunikimin e ndersjelle ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjetër;



c) mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

4. Perdorimi i mjeteve elektronike, qe mundeson ortaket te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per te garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike, deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve.

#### Neni 18

##### Përrjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përrgjitshme merr vendim për:


- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 19

##### Proçesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përrgjitshme duhet të regjistrohen në proçesverbal. Administratorët përrgjigjen për ruajtjen e kopjeve të proçesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përrgjitshme.
2. Proçesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të proçesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përrgjitshme.
4. Proçesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i proçesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të proçesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përrgjitshme në këtë faqe.



## Neni 20

### Të drejtat e lidhura me kuotën

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

## Neni 21

### Shperndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të ndajne pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shperndahet ortakeve në raport me kuotën e zotëruar.

## Neni 22

### Kufizimet e shpërndarjeve, çertifikata e aftësisë paguese

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratorët lëshojnë një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë çertifikatë.
3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavaresisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj në bazë të një marreveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte me pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.
4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese që leshohet në zbatim të këtij neni.



## Neni 23


### Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.
3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

## Neni 24

### Përrjashtimi i ortakut

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përrjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përrjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përrjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:



- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.


#### Neni 25

##### Pasojat e largimit dhe përjashtimit

1. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.
2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

#### Neni 26

Marredheniet e punes me personat e punesuar ne shoqeri rregullohen me kontraten e punes qe do te lidhet me secilin prej tyre dhe ne perputhje me legjislacionin e punes.



12

Neni 27

Per sa nuk eshte shkruar ne kete statut, do te behet referim ne dispozitat e legjislacionit tregtar dhe atij shqiptar ne pergjithesi.

Neni 28

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) originale, ne gjuhen shqipe, nga te cilat njera depozitohet prane QKB.

**ORTAKET THEMELUES TE "DM.ORGANIK" SHPK**

**1.Daklea Allko**

Daklea Allko 

**2.Edmond Zeqaj**

Edmond Zeqaj 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTER MERITA L. ISUFAJ



DATE 05/12/2020  
NR REP 969



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Ne Durres, sot me date 05 Dhjetor 2020 (dymije e njezet) dite e shtune, para meje noteres Merita ISUFAJ, anetare e Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Durres, me studio ne L.11, Rr.A.Goga, Perballe Gjykates, Durres, u paraqiten personalisht:

**1.Daklea Allko**, atesia Shaban, lindur ne Çorovode, Skrapar, me 20.02.1987, me numer personal I752200780 dhe banuese ne Tirane, L.21 Dhjetori, Rr.Ylbere Bylykbashi, Pallati nr.26/1, me shtetesi shqiptare, per identitetin e se ciles u sigurova me Pasaporten nr.BG9619749;

**2.Edmond Zeqaj**, atesia Muim, lindur ne Tirane, me 18.07.1989, me numer personal I90718063K dhe banues ne Tirane, L.5, Rr.Sami Frasheri, Pallati nr.11, Shk.3, me shtetesi shqiptare, per identitetin e te cilit u sigurova me Pasaporten nr.BJ9073654,

*ne cilesine e ortakeve themelues te shoqerise "DM.ORGANIK" SHPK, ne formim e siper;*

Shtetasit jane madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

**Baza ligjore:** Neni 128 i Ligjit nr.110, dt.20.12.2018 "Per Noterine";

Ata deklarojne se me vullnetin e tyre te lire e te plote, kane redaktuar ne 4(kater) origjinale, **Kontraten e Themelimit dhe Statutin e shoqerise "DM.ORGANIK" SHPK**, bashkelidhur dhe e nenshkruajne ne pranine time.

*Une noterja legalizoj autenticitetin e nenshkrimeve.*

Ne zbatim te ligjit nr. 9887, date 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te deklaruesve, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

Ne originalin e arkives aplikohet taksa e pulles.

NOTERE

Merita ISUFAJ